



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	24.07.2020
Referencë/a	08 nr. 44/2020
Për/Za/To :	Skender Daut Hoti Rexhep Sefer Hoti
Zona Kadastrale:	Çifllak
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor
Nga/Od/From/	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Sektori për Pronë
	Vendim për Uzurpim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Masar Kastratit nga fshati Çifllak nr.1037-2020 dt.06.03.2020, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar në pronësinë komunale, kundër të dyshuarit Rexhep Sefer Hoti dhe Skende Daut Hoti nga Çifllaku K.K.Rahovec, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (" Gazeta zyrtare e KASK ", nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Rexhep Hoti dhe Skender Hoti nga Çifllaku , kanë bërë rrethimin, lëvrimin dhe mbjelljen e prodhimeve bujqësore, ne pjesën e parcelës komunale, nr. 217-1 zk Çifllak, me kulturë kullos klasa e 5(pestë),e cila evidentohet si P.Sh e Kosoves K.K.Rahovec, duke bërë uzurpim arbitrar të pasurisë komunale, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1060 m².

II. Uzurpuesit arbitrar Rexhep dhe Skender Hoti nga Çifllaku, janë të obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara , të cekura në pikën **I** të këtij vendimi, ta lirojnë dhe të njëjtën ta kthejnë në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi.

III. Nëse të përmendurit në afatin e caktuar ligjor nuk e lirojnë, sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Uzurpimi është kryer në vitet .

V. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

A r s y e t i m

Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës i K.K Rahovec, duke vendosur sipas kërkesës nr.1037-2020 dt.06.03.2020, në çështjen administrative–uzurpim arbitrar në parcelën komunale nr.217-1 zk. Çifllak me kulturë kullos e klasa i 5-st ,në emër të P.Sh. e Kosovës K.K.Rahovec. Në bazë të shënimeve të siguruara nga elaborati kadastral, Rexhep dhe Skender Hoti nga Çifllaku, me lëvrimin dhe mbjelljen e kulturave bujqësore të cekura në pikën **I** në dispozitivin e këtij vendimi, dhe kopjes së planit të hartuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie , kanë bërë uzurpim arbitrar të pasurisë komunale, nr. 217-1 Zona Kadastrale Çifllak.

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë–Sektori për Pronë i K.K. Rahovec së bashku me gjeodetin e kësaj drejtorie kanë dal në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit së parcelës komunale nr. 217-1-0, ka konstatuar se të përmendurit me veprimet që ka ndërmarr kanë bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale në të cilën eksperti i gjeodezisë ka hartuar skicën e terrenit, me të cilën shihet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

Me ftesë të kësaj drejtorie është paraqitur Skender Daut Hoti , i cili ka dhënë edhe deklaratën e tij ku ka cekur se: Pjesën e parcelës në fjalë e kanë blerë gjatë viteve 80-82, nga Sejfi Lah Avdyli nga .fsh. Petkoviq (Guri i Kuq) dhe se në atë kohë kanë bërë marrëveshje gojore dhe ku kanë paguar parat për blerjen e kësaj parcele ,por se nuk kanë ofruar kurrfarë marrëveshje me shkrim (kontratë shitblerje) .

Me dt .21.01.2019, Masar Kastrati nga Çifllaku është paraqitur në zyrën e kësaj drejtori me kontratë për dhënieje në shfrytëzim afat shkurtë për 10 vite e në këtë pjesë të kësaj parcele

,kontratë III nr.44-2019, ku me vonë, në vitin 2020 do ta zbaton këtë kontratë dhe do ta fiton të drejtën e shfrytëzimit afatshkurtër, ndërsa titullar do të mbetet Komuna e Rahovecit.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelës në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, dhe provave tjera të siguruara në arkivin e kësaj drejtorie, është vërtetuar se të përmendurit (Rexhep dhe Skender Hoti), kanë bërë uzurpim arbitrar në pasurinë komunale.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e KASK”, 46/77 dhe 37/88 ”), është vërtetuar se të përmendurit kanë bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitiv të këtij vendimi.

U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës Kuvendi Komunal Rahovec, më datë 24.07.2020

08 nr. 44/2020

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës - Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit përmes kësaj drejtorie.

Hartuesi
Jurist i Diplomuar.


Nazmi Krasniqi



Drejtori
Jurist Diplomuar.


Afrim Oruqi